


Disa elemente të reja në dokumentin tonë

Përveç përdorimit të “Bullets”, numërimit, “Alignment”, përdorimit të Wordart-it dhe futjes së fotografive në dokumente, ekzistojnë edhe një varg instruksionesh të cilat mundësojnë në mënyrë automatike të fusim element të ri si P.SH. :

- Numërimi i faqeve
- Përdorimi i fusnotave
- Përdorimi i “**Headers**” dhe “**footers**”

Së pari të bëjmë një përsëritje le të fusim një fotografi (duhet vet ta dini se si bëhet).



Që të mund të vendoset një **OBJEKT (Fotografi, WordArt, Text Box, ...)** kudo në dokument dhe të zhvendosë tekstin ekzistues duhet që ta klikojmë **objektin** dhe pastaj klikojmë: **Format>(Picture, WordArt, Text Box,...)** dhe në tabin **LAYOUT** zgjedhet opcioni **SQUARE** dhe klikohet **OK**.

Që të numërojmë faqet në mënyrë automatike duhet që:

1. Të klikojmë **Insert>Page Numbers...**
2. Zgjedhim se a i dojmë numrat në majë të faqes (**Header**) apo në fund të faqes (**Footer**) si dhe a i dojmë ata në mes (**center**), Majtas (**Left**) apo djathtas (**Right**), eventualisht mund të zgjedhim se çfarë formati i dëshirojmë ata nëse klikojmë **Format...**
3. Klikojmë **OK**

Që të fusim një **Header** duhet që:

1. Të klikojmë **Viev>Headers and Footers** ose klikojmë dy herë te numri i faqes
2. E shkruajmë **Header-in**
3. Klikojmë **close** ose **Switch between Headers and Footers** për të vazhduar me **Footers** , e pastaj klikojmë **close**



Që të futim fusnota* ndjekim këta hapa:

1. Klikojmë **Insert>Footnote**
2. Mund ta lëmë **Autonumber** ose të shënojmë shenjën që markon fusnotat
3. Klikojmë **OK**
4. Shkruajmë fusnotën dhe pastaj klikojmë prap në tekst për të vazhduar tekstin

* Fusnota është teksti që përshkruan ose jep informacion më të hollësishëm për një fjalë apo fjalitë shenjuar nga ndonjë shenjë specifike (*- në rastin tonë) në dokument. Zakonisht përdoret në dokumente ku ceken fakte të ndryshme dhe në fusnotë shënohen referencat se ku mund të gjenden ato